



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË PRIZRENIT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Prizrenit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prizrenit (KPZ), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Prizrenit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Shpalosjet e detyrimeve kontingjente të prezantuara në raportin vjetor financiar ishin mbivlerësuar për 2,324,215€, pasi që vlerat e regjistruara nuk përputheshin me dokumentacionin mbështetës të vendimeve gjyqësore;
- B1 Prezantim jo i drejtë i shpenzimeve si rezultat i keqklasifikimit në kategori të ndryshme ekonomike në vlerë prej 846,846€;
- C1 Në pesë raste, pasuritë në vijim në vlerë 645,857€ që kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve arsimore, sportive dhe rrugëve lokale, nuk ishin regjistruar në SIMFK duke shkaktuar nënvlerësim të pasurisë në raportin vjetor financiar për këtë shumë; dhe
- A2 Shpalosjet e llogarive të arkëtueshme të prezantuara në raportin vjetor financiar ishin mbivlerësuar për 71,074€, për shkak të mos azhurnimit të regjistrit të të arkëtueshmeve me pagesat e operatorëve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Prizrenit kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Në një (1) rast të kontratës “Ndërtimi i qendrës kulturore Turke” në vlerë prej 1,696,285€, ishte bërë ndryshimi i paramasës pa aprovim paraprak nga menaxhmenti dhe nuk ishte azhurnuar kontrata me kushtet e reja;
- B2 Në tre (3) raste të projekteve për ndërtimin e infrastrukturës, ishte bërë iniciimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme;
- A4 Në katër (4) raste, Komuna kishte bërë subvencionim e OJQ-ve në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me rregullore; dhe
- B3 Në gjashtë (6) raste, faturat në total prej 653,686€, kishte vonesa në pagesë prej 15 deri në 213 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa ‘Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare’. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Prizrenit.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Prizrenit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Prizrenit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Prizrenit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Prizrenit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF). Pas kërkesës sonë për korrigjime, çështjet e identifikuar nga ne në lidhje me PVF-të janë korrigjuar. Fushat në të cilat janë vërejtur mangësi sa i përket raportimit financiar kishin të bënin me prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve, nënvlerësimi i regjistrit tek fusha e pasurive, mbivlerësimi i regjistrit të llogarive të arkëtueshme dhe mbivlerësimi i regjistrit tek detyrimet kontingjente. Sa i përket mos pajtueshmërisë me ligje, kishte dobësi në inicimin e projekteve pa mbulesë të fondeve, mos aprovim të ndryshimeve të paramasës nga menaxhmenti, procesi i subvencionimit, si dhe vonesa në pagesën e faturave.

Po ashtu janë identifikuar dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, monitorimin e subvencioneve, vonesa në realizim të punimeve tek investimet kapitale, si dhe mospërdorim të modulit për menaxhim të kontratave në E-prokurim.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 12 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, shtatë (7) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente në PVF

Gjetja

Bazuar në Rregulloren MF nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore (OB), neni 6, përcakton që OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare. Sipas nenit 18 të kësaj rregullore OB duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Në nëntë (9) raste të detyrimeve kontingjente, kishte gabime dhe pasaktësi në prezantimin e tyre në PFV, pasi që vlerat e regjistruara nuk përputheshin me dokumentacionin mbështetës të vendimeve gjyqësore, përfshirë raportet e vlerësimit të ekspertëve apo padive përkatëse, ku si rezultat, regjistri i detyrimeve kontingjente në PFV ishte mbivlerësuar për 2,324,215€.

Kjo situatë ka ndodhur për shkak të gabimeve me rastin e regjistrimit të detyrimeve kontingjente dhe mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme për identifikimin e gabimeve para prezantimit të tyre në PFV. Vlen të përmendet se, komuna kishte bërë përpjekje me Thesarin për t'i mundësuar

korrigjimin e këtyre vlerave të gabimeve që lidhen me detyrimet kontingjente në PFV, mirëpo për shkak të afatit të kufizuar, korrigjimi nuk i ishte mundësuar.

Ndikimi

Mbivlerësimi i detyrimeve kontingjente ndikon në raportimin e pa saktë të tyre në PFV dhe mund të çojë në vendimmarrje të gabuar dhe planifikim jo të mirë buxhetor nga ana e Komunës.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve në mënyrë që detyrimet kontingjente të shpalosura në PFV të jenë të sakta dhe të mbështetura në dokumentacion të nevojshëm për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Bazuar në Rregullën Financiare nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, neni 18, përcakton që shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Gjithashtu, me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë 846,846€ në kategori jo adekuate:

- Nga kategoria e investimeve kapitale në emër të mirëmbajtjes investive "Fshirje dhe larje e rrugëve" janë paguar 422,801€, shpenzime që për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime ishin buxhetuar në PIP në projektin "Rehabilitimi investiv i rrugëve dhe intervenimi i rrugëve të Prizrenit" për shkak të kufirit buxhetor të përcaktuar nga Ministria e Financave në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Gjithashtu, nga kjo kategori në bazë të vendimeve gjyqësore ishin paguar 208,324€ për paga jubilarë dhe shujta, obligime që rrjedhin nga kontrata kolektive;
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve në bazë të vendimeve gjyqësore ishin paguar 73,000€ për zhvillimin e softuerit dhe 132,721€ për shpronësime, shpenzime që sipas natyrës i takojnë investimeve kapitale; dhe
- Nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve nga kodi i subvencioneve për entitetet publike, janë paguar shpenzime në vlerë 10,000€ një operatori ekonomik për shërbimet e organizimit të një manifestimi, shpenzime të cilat i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit për shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shpenzimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive.

Ndikimi

Regjistrimi dhe pagesa e shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF. Shfrytëzimi i buxhetit të investimeve

kapitale për pagesën e shpenzimeve që i takojnë pagave dhe mëditjeve dhe mirëmbajtjes, ka reflektim negativ duke vështirësuar apo edhe pamundësuar realizimin si duhet të projekteve kapitale.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë planifikime të mirëfillta buxhetore sipas natyrës së shpenzimeve, ashtu që shpenzimet të paguhen dhe regjistrohen nga buxheti i kategorive përkatëse, në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja C1 - Mos regjistrim i pasurive në vijim në regjistrin e pasurive

Gjetja Bazuar në Rregulloren nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 6, paragrafi 3 përcakton që; “Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e- pasuria.” Më tutje neni 11 specifikon se pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim.

Gjatë auditimit të pasurive kemi identifikuar se, pesë (5) pagesa në vlerë 645,857€ të projekteve kapitale që ishin në fazën e investimeve në vijim dhe ende nuk kishin përfunduar, nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive në SIMFK, duke e nënvlerësuar regjistrin e pasurisë në raportin vjetor financiar për këtë vlerë. Këto pasuri kishin të bënin me ndërtimin e objekteve arsimore, sportive dhe rrugëve lokale, Gjatë kohës sa ishim ne në proces të auditimit (mars 2025), komuna na ka ofruar dëshmi për regjistrimin e këtyre pasurive në regjistrin e pasurisë për vitin 2025, por këto ndryshime nuk ishin reflektuar në pasqyrat financiare të vitit 2024.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i gabimeve teknike në regjistrimin e pasurisë, si dhe mungesës së kontroleve të brendshme me rastin e raportimit të pasurisë.

Ndikimi Mos regjistrimi i plotë i pasurive kapitale shkakton mbi/nënvlerësim të pasurive, si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare.

Rekomandimi C1 Kryetari duhet të sigurojë kontrole efektive në regjistrimin e pasurive, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Bazuar në Rregulloren nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore, neni 16, përcakton që “Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Komuna ka bërë prezantim jo të saktë të llogarive të arkëtueshme për leje ndërtimi në PFV, duke mbivlerësuar regjistrin e llogarive të arkëtueshme për 71,074€. Kjo pasi që, në regjistrin e llogarive të arkëtueshme i cili mbahet në Excel, kishte gabime në prezantim të shumës fillestare të borxhit të një operatori për 13,735€ dhe të njëjtë nuk i ishte zbritur as pagesa prej 57,338€ e cila ishte kryer në korrik të vitit 2024.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos azhurnimit të regjistrit të llogarive të arkëtueshme me pagesat e operatorëve.

Ndikimi

Prezantimi i pa saktë i llogarive të arkëtueshme ndikon në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme në PFV. Kjo mund të ndikojë në vendimmarrje të gabuara dhe në planifikim jo të saktë të të hyrave.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, me qëllim të përmirësimit të procesit të menaxhimit dhe raportimit të saktë të llogarive të arkëtueshme në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Ndryshimi i paramasës pa aprovim paraprak nga menaxhmenti dhe mos azhurnim i kontratës me paramasën e re

Gjetja

Bazuar në Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 71.1 thekson se, Menaxheri i kontratës rekomandon ndryshimin e kontratës duke përfshirë edhe arsyet për ndryshimin e kontratave ku ndryshimi i kontratës kërkon ndryshim të projektit dhe/apo specifikimeve teknike. Menaxheri i kontratës merr aprovimin paraprak të projektuesit të cilin ia bashkëngjijtë rekomandimet për ndryshim. Po ashtu neni 71.2, specifikon se aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës - amandamentimi i kontratës do të përgatitet nga Departamenti i Prokurimit. Amandamentimi i kontratës do të nënshkruhet nga palët që kanë nënshkruar kontratën bazë dhe do të ngarkohet në platformën elektronike. Ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet Operatorit ekonomik para: (a) Marrjes së aprovimit nga ZKA. Aprovimi në kuptim të këtij neni nënkupton aprovim përmes komunikimit zyrtar; (b) Zotimit të mjeteve për kontratën e ndryshuar. Më tutje, sipas nenit 19, specifikimet teknike, pika 19, përcakton që, asnjë kontratë për punë nuk mund të inicohet pa sigurimin e lejes/pëlqimet mbi lokacionin hapësinor ku do të bëhet ekzekutimi i projektit, dhe të gjitha lejet nga autoritetet rregullatore përkatëse për ndërveprimet me rrjetet e energjisë dhe lidhjet me sistemet e shërbimeve publike. Për më shumë, neni 70.5 përcakton se ZKA me vendim do ta emërojë Menaxherin e Kontratës dhe mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës.

Më 31.07.2023 ishte lidhur kontrata për projektin “Ndërtimi i qendrës kulturore Turke” në vlerë prej 1,696,285€, ku në të njëjtën datë kishin filluar edhe punimet për këtë projekt. Për shkak të sipërfaqes më të vogël të lejuar me lejen ndërtimore (4,089 m² kundrejt 5,235 m² të kontraktuara), u kërkuar revidimi i projektit nga Drejtori i Departamentit të Kulturës Rinisë dhe Sportit (DKRS) dhe kërkesa u miratua nga zyra projektuese. Vendimi për leje ndërtimore ishte bërë më 21.10.2024, një vit pas fillimit të punimeve, si pasojë e mungesës së përgatitjeve paraprake. Për këto ndryshime, nuk ekziston aprovimi i Kryetarit të Komunës, e as ndryshimet në kontratë me operatorin ekonomik. Vlera e pagesave për këtë kontratë deri në fund të vitit 2024 ishte 130,149€. Për më tepër, menaxheri i kësaj kontrate kishte dhënë dorëheqje më datën 24.10.2024 dhe nuk është caktuar zëvendësues, ndërsa menaxhimin e përkohshëm e ka marrë Drejtori i DKRS pa vendim zyrtar nga ZKA.

Kjo kishte ndodhur për shkak të fillimit të projektit në mungesë të përgatitjeve me dokumentacionin e plotë dhe të nevojshëm, si dhe mosrespektimit të rregullave të prokurimit me rastin e ndryshimeve në projekt. Vlen të përmendet se pas përfundimit të auditimit, ne kemi pranuar dëshmitë e revidimit të specifikacionit të këtij projekti, në vlerë prej 1,572,469€.

Ndikimi

Fillimi i projekteve pa dokumentacion të plotë ka rezultuar me kontraktim të një hapësire punimesh më të madhe sesa ajo e miratuar me lejen ndërtimore. Mospërshtatja e kontratës me situatën e re rrezikon mosrealizimin e punimeve të kontraktuara dhe mund të shkaktojë dëm

financiar për komunën.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë respektimin e rregullave të prokurimit sa i përket përgatitjes me dokumentacionin e plotë të nevojshëm para inicimit dhe kontraktimit të projekteve. Në rastet e revidimit të projektit, duhet të përshtatet specifikacioni teknik i ri dhe i njëjti të aprovohet nga OE, në mënyrë që të shmangen humbjet potenciale nga mosrespektimi i procedurave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Inicimi i procedurave të prokurimit pa fonde të mjaftueshme

Gjetja

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-221 për ndryshim dhe plotësim të ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, neni 37.1 përcakton që: “Organizata buxhetore nuk ndërmerr asnjë obligim gjatë vitit aktual fiskal në një shumë që i tejkalon fondet e ndara”. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 9 paragrafi 3, përcakton se nëse një autoritet kontraktues merr obligime që do të përmbushen në vitet e ardhshme, atëherë ZKF duhet të sigurojë që buxheti i miratuar ofron bazë të qëndrueshme për alokimin e fondeve dhe të përfshijë një dispozitë në kontratë që kushtëzon zbatimin e saj me miratimin e buxhetit të ardhshëm. Ndërkohë, sipas nenit 12, paragrafi 7 të Ligjit të Buxhetit nr. 08/L-260 për vitin 2024, nënshkrimi i kontratave për projekte kapitale shumëvjeçare lejohet vetëm nëse kostoja totale është e paraparë në buxhetin e vitit 2024 dhe për dy vitet pasuese.

Në tre (3) raste, Komuna kishte hyrë në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme financiare në kundërshtim me ligjin për ndarjet buxhetore, si në vijim:

- Për projektin “Ndërtimi i shtratit të lumëbardhit nga ura afër kampusit universitar” ishte lidhur kontrata më datën 04.03.2024, në vlerë prej 2,199,999€, derisa fondet e buxhetuara në Ligjin e buxhetit 2024 për tre (3) vite ishin vetëm 200,000€. Me ligjin e buxhetit për vitin 2025, për këtë projekt janë ndarë edhe 1,400,000€ për tre vitet e ardhme;
- Për projektin “Ndërtimi infrastrukturës në Korishë - projekt dy vjeçar” ishte lidhur kontratë më datën 09.02.2024, në vlerë prej 1,424,995€, derisa fondet e buxhetuara në Ligjin e buxhetit 2024 për tre (3) vite ishin vetëm 400,000€ (për vitin 2024- 100,000€, vitin 2025- 150,000€ dhe vitin 2026-150,000€). Me ligjin e buxhetit për vitin 2025, për këtë projekt ishin paraparë edhe 624,995€; dhe
- Për projektin “Ndërtimi i infrastrukturës në Romajë, rrugë dhe ndriçimi publik” ishte lidhur kontratë më datën 25.08.2024 në vlerë prej 336,666€, deri sa në fondet e buxhetuara për tre (3) vite në Ligjin e buxhetit 2024 ishin vetëm 60,000€. Me ligjin e buxhetit për vitin 2025, për këtë projekt nuk ishin paraparë mjete shtesë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të analizave jo të mirëfillta dhe vlerësimeve jo reale të kostove financiare të projekteve me rastin e buxhetimit të tyre.

Ndikimi

Mungesa e analizave të mirëfillta të kostove financiare dhe vlerësimeve realiste për projektet kapitale, si dhe hyrja në obligime pa sigurim të fondeve të nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papagueshme dhe

të shpenzimeve potenciale të përmbartimit, duke rrezikuar buxhetin e vitit aktual dhe atij të viteve në vijim.

Rekomandimi B2

Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të kostove financiare në fazën e buxhetimit, duke siguruar që për çdo projekt kapital, para fillimit të procedurave të prokurimit, të jenë të parashikuara fonde të mjaftueshme në Ligjin e Buxhetit dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Subvencionim në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me rregullore

Gjetja

Bazuar në Rregulloren komunale nr. 001/011-201 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, neni 6 paragrafi 2 përcakton se, personi fizik apo juridik vetëm 1 (një) herë në vit mund të jetë përfitues i subvencioneve, transfereve dhe granteve të ndara nga Komuna dhe pika 3 -Përgjashtim nga paragrafi 2 i këtij neni bëjnë subvencionet, transferet dhe grantet e ndara për rastet specifike dhe të arsyetuara nga ana e Komisionit, rastet kur nuk ka aplikues të tjerë për projekte të caktuara, dhe subvencionet dhe grantet e ndara në fushën e bujqësisë, apo projektet e financuara përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe bashkëfinancimit. Po ashtu, Rregullorja Nr.04/2017, neni 2 paragrafi 1 përcakton se; dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga çdo organizatë buxhetore e cila financon projektet dhe programet e OJQ-ve të cilat janë aplikues apo partner të aplikimit sipas thirrjes publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJQ-ve dhe të cilat plotësojnë kriteret sipas kësaj rregulloreje.

Në katër (4) ⁵ raste, Komuna kishte bërë subvencionime në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me rregullore si në vijim:

- Në një (1) rast të subvencionimit, OJQ kishte përfituar 17,000€ brenda vitit 2024, duke përfituar subvencionime për tri (3) projekte nga drejtori të ndryshme (10,000€ nga Drejtoria e Kulturës, 6,000€ nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, si dhe 1,000€ nga Drejtoria e Turizmit);
- Në një (1) rast tjetër të subvencionimit, OJQ kishte përfituar 10,000€ në emër të subvencioneve brenda vitit 2024, duke përfituar subvencionime për dy (2) projekte nga drejtori të ndryshme (8,000€ nga Drejtoria e Kulturës dhe 2,000€ nga Drejtoria e Turizmit);
- Në një (1) rast, OJQ ishte shpërblyer tri (3) herë brenda vitit 2024 dy herë në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit nga zyra e Kryetarit dhe një herë në bazë të thirrjes publike në kuadër të drejtorisë së turizmit. Vlera totale e subvencionimit gjatë vitit 2024 për këtë OJQ ishte 186,000€; dhe
- Në një (1) rast, OJQ ishte shpërblyer dy herë brenda vitit 2024, njëri projekt në vlerë 10,000€ nga Drejtoria e Kulturës dhe tjetri projekt në vlerë 2,500€ nga Drejtoria e Turizmit. Për më tepër, në rastin dytë të subvencionimit OJQ nuk i plotësonte kriteret e subvencionimit, madje as nuk ishte kualifikuar si përfituese nga komisioni i vlerësimit për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar me kritere (raportit financiar/narrativ nga viti paraprak), mirëpo pas ankesës, e njëjta ishte referuar për subvencionim nga komisioni për shqyrtim të ankesave. Vlera prej 10,000€ nuk është paguar ende, por ishte përfshirë në obligimet e vitit 2024.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për të respektuar kërkesat e rregulloreve përkatëse, me rastin e subvencionimit.

Ndikimi Dhënia më shumë se një herë brenda vitit e subvencioneve për përfituesit e njëjtë ndikon në mos transparencën e procesit dhe krijon pa barazi mes përfituesve. Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara me rregullore me rastin e subvencionimit ndikon në për zgjedhjen jo të drejtë të përfituesve dhe rritë rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që me rastin e subvencionimit të OJQ-ve të respektohen kufizimet e rregullores për numrin e përfitimeve brenda një viti dhe fondet të ndahen vetëm për OJQ-të që i plotësojnë kriteret e përcaktuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Bazuar në Ligjin 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 39.1, përcakton se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në gjashtë (6) raste, faturat në total prej 653,686€, kishte vonesa në ekzekutimin e pagesave prej 15 deri në 213 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Kjo kishte ndodhur për shkak të hyrjes në obligime financiare pa pasur fonde buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve.

Ndikimi Mos aplikimi i procedurave të duhura të kontrollit gjatë procesit të pagesave, mund të ndikojë që komuna të mos i kryej obligimet e faturuara me kohë, rrjedhimisht rritjen e obligimeve të papaguara, të cilat do të jenë barrë për buxhetin e vitit vijues.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 25,816,167€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 23,823,042€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, mirëmbajtjen e lumenjve, objektet arsimore, pajisje tjera etj.

Çështja B4 - Mospërdorim i modulit në E-prokurim për menaxhim të kontratave dhe vlerësim të performances së kontraktuesve

Gjetja Bazuar në Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70.2 përcakton se, “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualët për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Në nëntë (9)⁶ kontrata, menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes modulit përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave përdorin modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik për menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Vonesa në realizimin e projekteve kapitale

Gjetja Bazuar në Rregulloren nr. 001-2022 për prokurimin publik, neni 70.23, përcakton që menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Në tre (3) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:

- Kontrata "Rregullimi i infrastrukturës në lagjen Dardani II" në vlerë 855,555€, e nënshkruar më datë 08.11.2022, sipas planit dinamik prej 500 ditëve do të duhej të përfundonte në datën 08.08.2024, ndërkohë që deri në kohen sa ishim në auditim (mars 2025) ende nuk kishte përfunduar.;
- Kontrata "Zgjerimi dhe ndërtimi i rrugës me asfalt në fshatin Novak" në vlerë 402,335€, e nënshkruar më datë 06.12.2022, sipas planit dinamik prej 500 ditëve do të duhej të përfundonte në datën 05.08.2024, ndërkohë që deri në kohen sa ishim në auditim (mars 2025) ende nuk kishte përfunduar; dhe
- Kontrata "Ndërtimi i objektit të ri të shkollës në fshatin Pllanjanë" në vlerë 611,699€, e nënshkruar më datë 11.05.2021, sipas planit dinamik prej 600 ditëve do të duhej të përfundonte në datën 09.01.2024, ndërsa është përfunduar më 22.04.2024.

Vonesat në realizimin e projekteve kishin ndodhur për shkak të problemeve teknike me rrymë, me shpronësime dhe probleme të tjera që kishin rezultuar nga planifikimi jo i mirë i projekteve.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu, ndikon në performancën dhe mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit në aspektin teknik, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 505,943,459€, pasurive jokapitale është 3,243,841€, si dhe e stoqeve 396,442€.

Çështja B6 - Mos mbyllja e investimeve në vijim dhe regjistrimi i tyre si pasuri në përdorim

Gjetja

Bazuar në Rregulloren nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 11 specifikon se: “Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi”.

Gjatë testimit të pasurive kemi vërejtur se në 10 raste të pasurive të regjistruara si “Investime në vijim”, gjashtë (6) prej tyre janë në përdorim dhe janë pranuar teknikisht, ndërsa katër (4) janë në përdorim por nuk janë pranuar teknikisht. Të gjitha këto pasuri figuronin në regjistër si investime në vijim, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, ne nuk kemi mundur të kalkulojmë vlerën e gabimit të zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit të pasurisë në PFV.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite. Vlen të përmendet se krahasuar me vitin e kaluar, gjendja ishte përmirësuar dukshëm, pasi në gusht të vitit 2024, Kryetari kishte formuar një grup punues i cili është angazhuar për mbylljen e investimeve të përfunduara në regjistrin e pasurisë. Ky grup punues, edhe gjatë vitit 2025, është ende në proces të punës.

Ndikimi

Mungesa e pranimin teknik për pasuritë e përfunduara që janë në përdorim nga komuna ndikon në paqartësinë e statusit të tyre duke shkaktuar vlerësim jo të drejtë dhe raportim të pa saktë të tyre.

Rekomandimi B6

Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të prezantuara në PFV e vitit 2024 në total janë 27,289,164€. Saldo e të arkëtueshmeve kryesisht përbëhet nga tatimi në pronë, taksat për menaxhimin e mbeturinave, taksat për leje ndërtimi, taksat për biznese, qiraja nga shfrytëzimi i pronave komunale dhe të tjera.

Çështja B7 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Bazuar në Ligjin nr. 06-L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 27.1 përcakton që, nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Gjithashtu, sipas Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, komunat janë përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave vetanake dhe duhet të kenë sisteme të përshtatshme për të siguruar regjistrimin, monitorimin dhe inkasimin e të gjitha të hyrave komunale. Po ashtu, rregulloret komunale që rregullojnë tarifat për shërbimet publike (si mbeturinat), përcaktojnë afatet dhe mënyrën e pagesës, të cilat duhet të zbatohen në praktikë. Më tutje, sipas kontratave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale, qiraja mujore do të paguhet në fillim të çdo muaji e më së voni deri më datën pesë (5) të muajit vijues.

Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë 27,289,164€. Pjesa më e madhe e tyre i takon tatimit në pronë (50%), taksës nga mbeturinat (22%), taksës për leje ndërtimi (15%), taksës për bizneset (9%) dhe qirasë për shfrytëzimin e pronës publike (4%).

Në shtatëmbëdhjetë (17) raste në vlerë 496,096€, të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë, në një (1) rast në vlerë 10,557€, të llogarive të arkëtueshme nga shfrytëzimi i hapësirës publike, në tri (3) raste në vlerë 22,237€, të llogarive të arkëtueshme nga taksat komunale për biznese dhe në dhjetë (10) raste në vlerë 4,736€, tek llogaritë e arkëtueshme nga inkasimi i të hyrave nga mbeturinat, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbauesit për mbledhjen e këtij borxhi, edhe pse ishte tejkaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe afati në shkresat për rikujtimin e borxhit. Kjo ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin paraprak për 4,310,418€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme ligjore përmes përmbauesit në arkëtimin e të hyrave sipas afateve.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave ka ndikim negativ në nivelin e buxhetit, pasi krijon mungesë fondesh të mbledhura, duke penguar financimin dhe realizimin e projekteve komunale. Gjithashtu, kjo çon në vjetërsimin e këtyre llogarive, duke e bërë të pamundur arkëtimin e tyre.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁷	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	66,201,979	71,447,927	68,794,278	62,409,458	46,266,941
Grante Qeveritare - Buxheti	55,008,685	55,977,138	55,482,599	50,062,613	36,663,440
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	359,900
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	1,000,000	1,000,000	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	3,270,691	3,200,908	4,366,480	3,934,810
Të hyrat vetanake	10,193,294	10,193,294	9,312,646	7,885,742	5,118,768
Donacionet vendore	0	637,766	466,927	72,273	41,530
Donacionet e jashtme	0	369,038	331,197	22,349	148,492

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 5,245,948€, si rezultat i rritjes nga granti qeveritar 968,453€, të hyrave të bartura nga viti i kaluar 3,270,691€, si dhe donacioneve 1,006,804€.

Në vitin 2024 Komuna ka shpenzuar 96% të buxhetit final ose 68,794,278€, me realizim më të mirë se vitin e kaluar për 6% (2023 - 90%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	66,201,979	71,447,927	68,794,278	62,409,458	46,266,941
Pagat dhe mëditjet	26,406,900	27,466,351	27,419,172	25,709,009	21,098,714
Mallrat dhe shërbimet	12,740,224	12,917,748	12,581,586	11,829,897	10,135,739
Komunalitë	1,000,000	1,001,267	821,081	1,570,749	818,129
Subvencionet dhe transferet	4,000,000	4,246,394	4,149,398	3,537,966	2,562,388
Investimet Kapitale	22,054,855	25,816,167	23,823,042	19,761,836	11,651,971

- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar të kategoria paga dhe mëditje ishte rritur për 1,059,451€, prej tyre 968,453€ si rezultat i grantit shtesë të qeverisë në fund të vitit dhe 90,998€ nga donacionet e jashtme;


- Buxheti final në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 177,524€. Rritja ishte rezultat i të hyrave të bartura prej 157,244€, si dhe donacioneve të jashtme 20,280€. Realizimi i buxhetit të kjo kategori ishte 97% e buxhetit final, derisa, në fund të vitit janë regjistruar obligime të papaguara tek kjo kategori në vlerë 1,329,619€;

- Buxheti final në kategorinë e komunalive në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,267€, ndërsa realizimi ishte 82%;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur 246,394€. Rritja ishte rezultat i bartjes së të hyrave vetanake. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 98% e buxhetit final; dhe

- Buxheti final për kategorinë e investimeve kapitale në krahasim me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,761,312€. Rritja ishte rezultat i bartjes së të hyrave vetanake. Realizmi në këtë kategori ishte 92% e buxhetit final. Projekti "Eficienca e energjisë në ndërtesat publike" në vlerë 1,000,000€, i planifikuar për vitin 2024, si financim nga huamarrja nuk është zbatuar gjatë këtij viti, si rezultat i vonësve nga BERZH-i (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim). Ky projekt sipas shënimeve shpjeguese në raportin financiar pritet të implementohet gjatë vitit 2025.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e planifikuara për vitin 2024 ishin 10,193,294€, ndërsa janë realizuar 8,406,771€, apo 82% nga plani për shkak të mos gatishmërisë së qytetarëve për të paguar obligimet. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2024 Komuna e Prizrenit ka përfituar të hyra nga gjobat në trafik, gjoba të gjykatave si dhe gjobave nga pyjet në vlerë totale prej 2,042,476€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikon dhe i realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	10,193,294	10,193,294	8,406,771	9,579,478	7,538,665
Të hyrat tatimore	4,198,412	4,198,412	2,511,507	3,580,180	2,572,438
Të hyrat jo tatimore	5,994,882	5,994,882	5,892,462	5,999,299	4,944,441
Të hyrat tjera	0	0	2,802		21,785

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2023 për Komunën e Prizrenit ka rezultuar me 13 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2023 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Prizrenit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, tre (3) rekomandime janë zbatuar, një (1) rekomandim është zbatuar pjesërisht, shtatë (7) rekomandime nuk kanë filluar të zbatohen ende, si dhe dy (2) nuk janë të aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë mbikëqyrje dhe kontroll mbi komisionet/organet mbikëqyrëse për pranim të furnizimeve me lëndë djegëse. Po ashtu, menaxheri i kontratës duhet të jetë më përgjegjës që furnizimet e tilla të bëhen në kohën e duhur.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2024.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë se çdo marrëveshje me përfituesit/fermerët me rastin e dhënies së subvencioneve të çfarëdo mekanizmi bujqësor do të përfshijë elementet përkatës, duke kërkuar vendosjen e numrave serik të të gjitha rasteve të tilla.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2024.	I zbatuar

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të rishikoj shkaqet e mos përdorimit të sistemit e-prokurimi dhe të ndërmarrë masa shtesë të kontrollit për të siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet në sistemin elektronik të prokurimit publik.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës në rastet e tilla do të marrin masa korrigjuese të menjëhershme për të zbatuar detyrimin ligjor të raportimit të vendimeve për kompensim për inflacion në platformën elektronike të prokurimit publik. Po ashtu të kërkoj veprime apo mekanizma shtesë për realizimin e projektit nga operatori ekonomik apo të ndërmerr hapa tjerë ligjor.	Kjo çështje nuk është reflektuar në vitin 2024, për shkak skadimit të afatit nga ligji për inflacion dhe si i tillë nuk ka qenë i zbatueshëm për vitin 2024.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të siguroj se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi, si dhe të kryhet pagesa.	Ky rekomandim konsiderohet i mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më
6.	Baza për konkluzion	Kryetari të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në menaxhimin e kontratave duke zbatuar një mbikëqyrje të rregullt dhe efektive. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet riridestnimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të forcojë kontrollet gjatë vlerësimit të projekteve, duke siguruar që para inicimit të procedurave të prokurimit për çdo projekt kapital të ketë fonde të mjaftueshme për realizimin e projekteve	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Pasuritë	Kryetari duhet të siguroj regjistrimin e plotë të pasurive kapitale në SIMFK në kohën e duhur dhe pasurit jo kapitale të regjistrohen në e-pasuri me informatat e duhura sipas nën kodeve ekonomike të kërkuara. Po ashtu, duhet të siguroj se procesi i inventarizimit kryhet me kohë dhe këto raporte të harmonizohen me gjendjen e pasurisë në regjistra dhe ti paraprijnë përgatitjes së PVF, në mënyrë që vlera e pasurisë të prezantohet saktë.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024 pjesërisht, pasi që disa pasuri nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurisë. Derisa për pjesën e inventarizimit, janë ndërmarrë veprime.	Pjesërisht i zbatuar
11.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme, përmes ndërmarrjes së veprimeve të nevojshme me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
13.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohë dhe brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit



Astrit Bllaca, Anëtar i ekipit



Lumni Mazreku, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së
lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente në PVF	Ne edhe gjate takimit përmbyllës por edhe ne shkresën e datës 06.05.2025 derguar per kete çështje kemi dhene argumentet dhe arsyet tona. Me gjithate edhe tani ne pika kryesore po ju pershkruajm mos pajtimin tone: 1. Gabimi i regjistrimit ka ndodhur gjatë procesit të përpunimit të dhënave, dhe është shkaktuar nga një gabim teknik në regjistrimin e shumës. Ky gabim ka quar në pasqyrimin e një vlere më të madhe se sa është e vërteta; 2. Detyrimi kontingjent i regjistruar është analizuar menjëherë pas identifikimit të gabimit dhe është korrigjuar për t'u harmonizuar me shënimet origjinale dhe me marrëveshjet përkatëse, ku me datë 17.03.2025, përfaqësuesja ligjore ka dërguar shkresën ku ju ka njoftuar për korrigjimin e gabimeve në bazën e të dhënave e mirëmbajtur nga ana e zyrtarëve të saj. Këto ishin gabime teknik të pavullnetshme, dhe ne e kemi adresuar këtë çështje për të siguruar që pasqyrat financiare pasqyrojnë detyrimet kontingjente të Komunës së Prizrenit. Gjithashtu sa për sigurinë tuaj të gjitha shënimet e korrigjuara janë në harmoni me gjendjen faktike të dokumenteve lidhur me detyrimet kontingjente, prandaj komuna në këtë rast nuk është ekspozuar para ndonjë rreziku financiar, por vetëm që në pasqyra është pasqyruar vlere jo e saktë, për të cilat gabime janë të njoftuar edhe përfaqësuesit e thesarit dhe si të tilla pasi që pasqyrat financiare nuk i nënshtrohen publikimit publik (nuk publikohen), por vetëm për MFTP, konsiderojmë që gjendja reale dhe ajo që ofron siguri janë obligimet e prezantuar në dokumente faktike.	Në raportin e auditimit, ne kemi shpalosur se arsyeja që kjo çështje ka ndodhur është për shkak të gabimeve me rastin e regjistrimit të detyrimeve kontingjente. Po ashtu, kemi potencuar se Komuna kishte bërë përpjekje me Thesarin për t'i mundësuar korrigjimin e këtyre vlerave të gabimeve që lidhen me detyrimet kontingjente në PFV, mirëpo për shkak të afatit të kufizuar, korrigjimi nuk i ishte mundësuar. Arsyetimet tuaja, nuk e ndryshojnë gjendjen. E gjetura mbetet e pa ndryshuar.
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve	KOMENTI 1: 1.Mungesa e mjeteve buxhetore në	Arsyetimet e shpalosura nga Komuna në lidhje me keq

kategori në mallra dhe shërbime: Organizata jonë ka pasur mungesë të mjeteve të mjaftueshme për të përballuar nevojat emergjente të mirëmbajtjes përmes kategorisë së rregullt të shpenzimeve nga mallrat dhe shërbime, për shkak të kërkesave të mëdha në këtë kategori dhe caktimit të kufirit buxhetor nga Ministria e Financave, e cila shumë e lejuar në kornizën buxhetore nuk i përmbush kërkesat e mëdha për mallra dhe shërbime për organizatën tonë;

2. Miratim nga niveli qendror: Me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së shërbimeve esenciale për qytetarët dhe funksionimin e infrastrukturës, është propozuar në buxhetin e vitit 2024, konkretisht në kodin e projektit 54570, i cili buxhet i ka kaluar të gjitha aprovimet e nivelit lokal dhe qendrorë, konkretisht nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nga të cilët është aprovuar çdo kod buxhetor duke potencuar në PIP edhe arsyen e shpenzimit.

3. Karakteri i jashtëzakonshëm i buxhetimit: E theksojmë se kjo zgjidhje është përdorur si masë e përkohshme dhe e domosdoshme, me qëllim të garantimit të sigurisë publike dhe funksionalitetit komunal.

KOMENTI 2:

Kjo situatë ka rezultuar në keq klasifikim, për të cilin theksojmë se:

- Nuk ka qenë vendim apo veprim i ndërmarrë nga ana e komunës, por një pasojë e drejtpërdrejtë e procedurës përmbartimore jashtë kontrollit tonë;

- Paga është zbatuar automatikisht sipas gjendjes likuide të llogarive buxhetore në momentin e ekzekutimit të përmbartimit;

- Organizata nuk ka pasur kontroll mbi përzgjedhjen e kategorisë buxhetore në momentin e zbatimit të përmbartimit, pasi mjetet janë tërhequr automatikisht nga Thesari në bazë të disponueshmërisë së llogarive, ku në shumicën e rasteve zyrtaret nga thesari as që kanë informuar përgjegjësit e komunës se

klasifikimet, nuk e ndryshojnë gjendjen.

E gjetura mbetet e pa ndryshuar.

	nga cilat kategori do të tërhiqen mjetet financiare. Në disa raste zyrtarët nga thesari kanë potencuar se mjetet nuk mund të tërhiqen nga kategoria e pagave, në mungesë të mjeteve financiare, por do të tërhiqen nga kategoritë tjera ekonomike, gjithashtu, ne kemi dërguar shkresa dhe kemi realizuar takime individuale me zyrtarët financiar të thesarit, që ti bëjnë korrigjimet e duhura në ato raste ku kemi pasur mjete, mirëpo një gjë e tillë nuk është bërë e mundur nga ana e zyrtareve në thesar.	
--	---	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
Nr. 356/25 Dt. 17.06.2025



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren - Prizren Belediyesi

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Prizrenit, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem **pjesërisht** me gjetjet dhe rekomandimet e draftraportit dhe në nuk pajtohem për këto çështje:
Çështja A1 - Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente në PVF;
Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve (e gjetura për pagesat përbarimore: Nga kategoria e investimeve kapitale në emër të mirëmbajtjes investive janë paguar 422,801€, shpenzime që për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve dhe nga kjo kategori në bazë të vendimeve gjyqësore ishin paguar 208,324€ për paga jubilarë dhe shujta, obligime që rrjedhin nga kontrata kolektive).
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Shaqir Totaj

Kryetar i Komunës së Prizrenit

Data: 17.06.2025 Prizren



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁸ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁹, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1. OJQ " Sarski Behar" në shumë totale 17,000€ (1,000€ nga drejtoria e turizmit, 6,000€ nga drejtoria e mirëqenies sociale, 10,000€ nga drejtoria e kulturës), 2. OJQ " Zëri aktiv i femrave" ishte shpërblyer dy (2) herë në shumë totale 10,000€(2,000€ nga drejtoria e turizmit, 8,000€ nga drejtoria e kulturës), 3. OJQ "Maker space" ishte shpërblyer tre (3) herë brenda vitit 2024, (prej tyre dy pa thirrje publike në vlerë totale prej 183,000€ vetëm në baze të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe një me thirrje publike nga drejtoria e turizmit në vlerë 3,000€) në shumë totale prej 186,000€. 4. OJQ Plan është shpërblyer 12,500€ drejtori të kulturës në shumë 10,000€ dhe 2,500€ në kuadër të drejtorisë të Turizmit.
- ⁶ 1.Rehabilitimi dhe revitalizimi i hapësirave publike në zonën e parë të mbrojtur në pjesën e vjetër të qytetit, Ndërtimi i rrugës Shuaip Spahiu, projekt dyvjeçar 2.Ndërtimi i qerdhes në Lagjen Tusus Prizren (projekt dy vjeçar) 3.Ndërtimi i aneksit të objektit shkollor Ardhmeria në Fshatin Landovicë 4.Ndërtimi i kanalizimit,rrugët dhe rregullimi i përrockës në fshatin Jeshkovë 5.Ndërtimi i objekteve kulturore, rinore dhe sportive në lagjen Bajram Curri, dhe në fshatrat Planejë, Medvec, Kushnin të hasit, Zojz, Zhur, Reçan dhe Billushë. 6.Rregullimi i murave mbrojtëse në Komunën e Prizrenit, Landovicë, Randobravë Fshatrat e Zhupës, Has, Vërri e tjera. 7.Ndërtimi i qendrës së mjekësisë familjare në ambjentet e ish KFOR it në Prizren (Projekt tre vjeçar) 8. Ndërtimi i hapësirave të varrezave të martirëve në Landovicë 9. Ndërtimi i banesave sociale në lagjën Petrovë në Prizren-faza e dytë-projekt dy vjeçar.
- ⁷ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁸ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁹ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.